



**REPUBLIKA E SHQIPÉRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN**  
**E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 221/3 Prot:

Tiranë, më 8/04/2016

**VENDIM**

Nr. 11, datë 8/04/2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënavë Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Fondacioni Klinika Ortodhokse "Ungjillëzimi",

**VËREJ SE :**

Në zbatim të Urdhrit nr. 42, datë 22/02/2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënavë Personale, është kryer hetim administrativ pranë kontrolluesit Fondacioni Klinika Ortodhokse "Ungjillëzimi", me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit Fondacioni Klinika Ortodhokse "Ungjillëzimi", i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënavë Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënavë personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënavë Personale, pas shqyrtimit të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara konstaton se:

1. Kontrolluesi e ka plotësuar detyrimin për "Njoftim" referuar nenit 21 të ligjit. Gjatë verifikimit të përbajtjes së "Njoftimit", është konstatuar se kontrolluesi nuk e ka kryer njoftimin në mënyrë të plotë, të saktë dhe në përpunim me nenin 22 të ligjit, referuar verifikimit të dokumentacionit të përgjithshëm, akt marrëveshjeve me palë të treta dhe detyrimeve ligjore që rrjedhin në kuptim të funksionimit të aktivitetit të tij. Sipas nenit 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënavë Personale", njoftimi duhet të përbajë:
  - a) emrin dhe adresën e kontrolluesit;
  - b) qëllimin e përpunimit të të dhënavë personale;
  - c) kategoritë e subjekteve të të dhënavë dhe kategoritë e të dhënavë personale;
  - ç) marrësit dhe kategoritë e marrëve të të dhënavë personale;
  - d) propozimin për transferimet ndërkombëtare që kontrolluesi synon të kryejë;

dh) një përshkrim të përgjithshëm të masave për sigurinë e të dhënave personale.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, konkludojmë se kontrolluesi nuk ka deklaruar përpunimin e të dhënave personale të subjekteve pacientë dhe punëmarrës si dhe nuk ka deklaruar në lidhje me përhapjen e të dhënave drejt palëve të treta si shoqëri sigurimi, banka, tatime etj.

2. Në zbatim të nenit 27 (Masat për sigurinë e të dhënave personale) të ligjit, konstatohet se kontrolluesi ka prezantuar dy rregullore të brendshme:

- Rregullore e brendshme e klinikës "*Ungjillzimi*". Në këtë rregullore është parashikuar orari i punës, mungesat, uniforma, marrëdhëniet me personelin, privatësia dhe konfidencialiteti.
- Rregullore e Fondacionit Klinika Orthodhokse e "*Ungjillzimit*" për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Kjo rregullore "*tip*", e miratuar nga zyra e komisionerit, nuk është e përshtatur sipas kushteve të aktivitetit të kontrolluesit.

Rregullorja "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*" është fiktive, e pazbatueshme në mënyrën dhe formën në të cilën ndodhet. Kjo është rregullorja "*Model*" e publikuar në portalin zyrtar të K.D.I.M.D.P.-së. Në këtë rregullore nuk ka udhëzime, masa dhe kërkesa specifike në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet mjeteve elektronike apo mekanike nga personeli i Kontrolluesit. Parë në fryshtë e ligjit, nen 27 i tij, konkludojmë se kontrolluesi nuk ka marrë masa të përshtatshme organizative në lidhje me sigurinë e të dhënave personale që përpunohej gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij.

3. Kontrolluesi ka vendosur një sistem Video-Survejimi (CCTV) me qëllim garantimin e sigurisë së ambienteve të jashtme si oborri, gjeneratori dhe hyrja e jashtme në ambientin e klinikës.

Gjatë kontrollit është konstatuar se kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), detyrim që buron nga nen 18 i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrotjen e të Dhënave Personale*" si dhe Udhëzimi nr. 23/2012 "*për përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*".

4. Grupi i kontrollit konstaton se kontrolluesi ka Akt Marrëveshje me palë të treta si me "*Intersig VIG*", "*Sigal Life Unica Group Austria sh.a.*" dhe "*Sigma Interalbanian VIG sh.a.*". Objekti i këtyre marrëveshjeve, kryesisht, është që kundrejt shpërblimit, klinika merr përsipër të kryejë ekzaminimet mjekësore dhe analizat për Aplikantët të cilët do të dërgohen nga këto kompanji sigurimi.

Parë në fryshtë e Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrotjen e të Dhënave Personale*", nenet 27 dhe 28 të tij, rezulton se aktimarrëveshjet nuk janë në përputhje me Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve midis kontrolluesit dhe përpunuesit...*"

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbal i kontrollit administrativ, datë 25/03/2016, ku përfaqësuesit e kontrolluesit u shprehën se pretendimet do ti paraqesin në seancë dëgjimore.

Në zbatim të neneve 93 e vijues të Ligjit nr. 8485/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", më datë 05/04/2016 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimin e grupit të kontrollit administrativ, përparrë marrjes së vendimit përfundimtar.

Në seancë dëgjimore kontrolluesi pretendoi se:

- 1) Nuk ka shkelje sa i përket rubrikës "Njoftimi".

Pretendimi i kontrolluesit nuk qëndron për arsy se gjatë inspektimit është dokumentuar se referuar akt Marrëveshjeve respektive, është parashikuar përhapje të dhënash personale shëndetësore drejt kompanive të sigurimeve.

Sa i përket përbajtjes së njoftimit, nenit 21 i ligjit parashikon:

*"I. Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë."*

- 2) Në lidhje me pretendimin që kontrolluesi paraqet për rregulloren, zyra e komisionerit konstaton se nga verifikimet e bëra, rezulton se një rregullore e tillë është tepër formale dhe nuk përshtatet me kërkesat që ligji ka vënë për kontrolluesit në ushtrimin e aktivitetit të tillë. Sidomos në kushtet e kontrolluesve të cilët ushtrojnë aktivitet në fushën e shëndetësisë, rregulloret duhet të janë sa më specifike.
- 3) Sa i përket mos informimit të subjekteve të të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimi (CCTV), konstatimi i bërë nga ana e inspektorëve është i drejtë, pra shkelja është evidentuar, por nga ana tjetër kontrolluesi ka marrë masa të menjëherëshme duke vendosur tabelat informuese sipas modelit standard të miratuar nga zyra e komisionerit, gjë që tregon që ai ka riparuar shkeljen e konstatuar.

Si përfundim, zyra e komisionerit konkludon se shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë "kundërvajtje administrative" dhe sankzionohen me gjobë.

- "b) Kontrolluesit, që nuk përbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë. ";
- "dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatesisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë. "

Kontrolluesi, Fondacioni Klinika Ortodhokse "Ungjillëzimi", në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij nenit.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara kanë të bëjnë me detyrimin për të informuar subjektet e të dhënave dhe marrje e masave lidhje me përpunimin e të dhënave, sigurinë, konfidencialitetin dhe detyrimet që i dalin kontrolluesit në zbatimin e Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, nenit 39/1, në të cilin parashikohet se: "Rastet e përpunimit të të dhënave në

*kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë..etj”*

Komisioneri gjithashtu, ka parasysh faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ.

#### PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të nenit 22 dhe 39/1 shkronja “b” dhe “dh” të Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

#### VENDOSA :

1. Dënimin e kontrolluesit Fondacioni Klinika Ortodokse “Ungjillëzimi”, me gjobë në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,
2. Dënimin e kontrolluesit Fondacioni Klinika Ortodokse “Ungjillëzimi”, me gjobë në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
3. Kontrolluesi të kryejë në mënyrë të plotë dhe të saktë përditësimin e njostimit sipas nenit 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, detyrim i cili të kryhet brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
4. Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 8/04/2016

